



**UNIVERSITETI I PRISHTINËS**  
**FAKULTETI JURIDIK**

Agim Ramadani, pn., 10000 Prishtinë, Kosovë

Tel: +381-38-229 063, 220 484 • email: juridiku@uni-pr.edu • URL: <http://www.juridiku.uni-pr.edu>

**Dekani: Prof.Ass.Dr. Avni Puka**

**Nr.prot:**

03/265

**Datë:**

01/06/2021

Duke u bazuar në nenin 76 paragrafi 1.6 i Statutit të Universitetit të Prishtinës si dhe Rregulloren për Studimet e Doktoratës, nr.1/775, datë 09.09.2014 dhe nenin 9 paragrafi 3 dhe 14 paragrafi 1.2 të Rregullores për punën e Këshillit të Fakultetit, në mbledhjen e mbajtur me 19.05.2021, Këshilli i Fakulteti Juridik nxjerr:

**KONKLUZIONE**

1. Gjatë semestrit të parë, përveç pjesës së ligjëratave, mësimeve mbikëqyr studentët e doktoratës nëse janë duke e përpunuar materialin në lidhje me temat që janë pjesë e programit. Studenti i doktoratës në vazhdimësi konsultohet dhe mban të informuar mësimeve në lëndës lidhur me ecurinë e përgatitjes së materialit për dhënien e provimit.
2. Provimi në lëndët e semestrit të parë mbahet në mënyrë të kombinuar, me shkrim dhe me gojë. Nga provimet e semestrit të I-rë studenti grumbullon 30 ECTS kredi.
  - 2.1. Provimi me shkrim mbahet nga profesori i lëndës në formë të pyetjeve/eseve analitike (të paktën 3 pyetje/ese nga temat e përfshira në program, të trajtuara gjatë ligjëratave dhe sipas udhëzimeve nga mësimeve, duke pasur parasysh edhe konceptin didaktik të mësimeve).
  - 2.2. Pjesa e provimit me gojë që nënkupton argumentimin e eseve/pyetjeve me shkrim dhe përgjigjet në pyetjet rreth temave të programit të lëndës mbahet nga profesori i lëndës dhe profesorët e lëndëve tjera në drejtimin (programin) përkatës. Vlerësimi përfundimtar bëhet nga profesori i lëndës. Në rast se në një lëndë janë më shumë se një bartës, vlerësimi i doktorantit me shkrim dhe me gojë do të jetë kumulativ.
  - 2.3. Studenti që nuk e kalon me sukses provimin në lëndën përkatëse, i jepet edhe një mundësi e dytë nga bartësi i lëndës, jo me herët se një (1) muaj nga vlerësimi negativ. Edhe herën e dytë, provimi organizohet me shkrim dhe me gojë.
  - 2.4. Përjashtimisht, doktorantit mund t'i lejohet nga Dekani hyrja edhe njëherë në provimin e njëjtë, me komision. Komisioni përbëhet nga 3 profesorë, përfshirë bartësin e lëndës. Në rast se doktoranti dështon për të kaluar provimin edhe herën e tretë, ai/ajo humb statusin e studentit doktorant.

3. Gjatë semestrit të dytë studentët e doktoratës angazhohen në hartimin e seminareve nga grup lëndët e parapara në programin studimor të akredituar, nga të cilat grumbullojnë 30 ECTS kredi.
  - 3.1.Seminaret e lëndëve të parapara në programin e studimeve duhet të punohen me standarde të larta akademike dhe shkencore, në atë mënyrë që të paraqesin punë hulumtuese, duke respektuar rregullat e hulumtimit dhe ndershmërisë akademike.
  - 3.2.Seminaret përmbajnë 10.000 deri në 20.000 fjalë, duke përdorur stilin e citimit, sipas standardit të Revistës “E Drejta”.
  - 3.3.Të paktën një (1) nga seminarat e hartuara në semestrin e dytë nga doktorantët duhet të botohet në revistën e Fakultetit Juridik “E Drejta”, si punim sipas standardeve të revistës.
  - 3.4.Punimet seminarike duhet të mbrohen publikisht para mësimdhënësve të lëndëve profesionale që janë të parapara në program. Data e mbrojtjes është publike dhe caktohet në koordinim në mes të mësimdhënësit dhe studentit.
  - 3.5.Studentët konsiderohet se e kanë përfunduar semestrin e dytë, vetëm pasi ta kenë botuar njërin nga seminarat në revistën e Fakultetit Juridik. Për këtë qëllim pranohet edhe konfirmimi me shkrim nga Këshilli i redaksisë së revistës mbi pranimin e seminarit për publikim.
4. Me qëllim të afirmimit të punës hulumtuese dhe rezultateve të arritura, studentët e doktoratës inkurajohen që disertacionin e doktoratës ta shkruajnë në gjuhë angleze dhe të kenë një bashkë-mentor të huaj.
5. Në rastin kur disertacioni i doktoratës shkruhet në gjuhën shqipe, një përmbledhje, struktura dhe konkluzionet përkthehen në gjuhë angleze dhe vlerësohen nga një profesor ndërkombëtar, para se të nënshkruhet raporti për vlerësimin e temës nga Komisioni për mbrojtje publike.
6. Studentët e doktoratës janë të obliguar të ndjekin trajnimet, kurset dhe mobilitetet që organizohen nga Fakulteti Juridik në bashkëpunim me universitetet dhe institucionet tjera partnere.
7. Studentët e doktoratës duhet të marrin pjesë në programet/projektet hulumtuese që mund të zhvillohen nga Fakulteti Juridik gjatë periudhës së studimeve dhe përkojnë me fushën e tyre të studimeve.
8. Këto konkluzione kanë për qëllim ngritjen e cilësisë dhe përmbajtja e tyre është në pajtim me dispozitat e statutit dhe rregullores në fuqi për studimet e doktoratës.

9. Konkluzionet do të publikohen dhe t'i kumtohen doktorantëve si dhe të njëjtat kanë fuqi obliguese, deri në ndryshimin e tyre.
10. Konkluzionet hyjnë në fuqi ditën e miratimit nga Këshilli i Fakultetit Juridik.

**Kryesues i Këshillit**

**Prof.Ass.Dr. Ayni Puka - Dekan**

